

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 1 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

Fair Fares NYC

Kushtet e përdorimit dhe informacione të tjera të rëndësishme për Departamentin e Shërbimeve Sociale të Qytetit të Nju-Jorkut (New York City Department of Social Services)/Administrata e Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration)

Zbritje e Fair Fares në udhëtimet me metro dhe autobus urban ose "Access-a-Ride" (Albanian)

Programi Fair Fares New York City (FFNYC) (Programi) administrohet nga Departamenti i Shërbimeve Sociale/Administrata e Burimeve Njerëzore (DSS/HRA). Programi i lejon individët e kualifikueshëm të përdorin metronë, autobusët urbanë dhe shërbimin e transportit individual "Access-A-Ride" (AAR) me gjysmë çmimi.

Regjistrimi në programin Fair Fares NYC:

Nëse përmbushni kërkesat e kualifikueshmërisë së Programit dhe nëse ka fonde të disponueshme, do të merrni zbritjen e FFNYC-së dhe do të regjistroheni në program për një vit. Do të regjistroheni për një nga zbritjet e mëposhtme (cilado që zbatohet në kohën e regjistrimit):

- Zbritje për metrotë e Autoritetit të Transportit Metropolitan (Metropolitan Transit Authority, MTA) - Autoriteti i Transportit të Qytetit të Nju-Jorkut (New York City Transit, NYCT) dhe autobusët urbanë (duke përfshirë Bee-Line, Nassau Inter-County Express, Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram, dhe Hudson Rail Link); **ose**
- Access-A-Ride.

Nëse nuk do të jeni më të kualifikueshëm në një pikë të caktuar kohore, Programi do t'ju çregjistrojë dhe zbritjet do të ndërpriten. Programi do t'ju njoftojë me email në adresën që keni në dosje nëse jeni çregjistruar.

Kualifikueshmëria për FFNYC-në

Banorët e NYC-së mund të jenë të kualifikueshëm për FFNYC nëse:

- Janë nga 18 deri në 64 vjeç (duke përfshirë këto dy mosha);
- Janë pjesë e një familjeje që përmbush udhëzimet në lidhje me të ardhurat për programin FFNYC;
- Nuk marrin tarifë transporti të plotë nga DSS/HRA ose nga një agjenci tjetër e NYC-së; **dhe**
- Nëse zgjedhin zbritjen e FFNYC-së për metro dhe autobusë, nuk po marrin pjesë ose nuk janë të kualifikueshëm për të marrë pjesë në një program tjetër për zbritje të tarifave të transportit.

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 2 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

Kalimi nga karta MetroCard e Fair Fares (FFM) në pagesën One Metro New York (OMNY):

Programi nuk lëshon më karta MetroCard të Fair Fares (FFMs). Nëse keni një FFM, mund ta përdorni deri kur (cilado është më e hershme):

- Karta FFM të skadojë (data e skadimit ndodhet në pjesën e pasme të kartës suaj);
- Karta FFM të mos funksionojë më;
- Karta FFM të çaktivizohet; **ose**
- Kur të mos jeni më të regjistruar.

Kushtet e përdorimit që keni nënshkruar tashmë zbatohen ende për kartën tuaj MetroCard për sa kohë që ajo është në fuqi.

Ju do të kaloni nga MetroCard në OMNY:

- Kur të rinovoni regjistrimin tuaj në program, **ose**
- Nëse e raportoni kartën tuaj MetroCard si të humbur, të vjedhur ose të dëmtuar.

Ju mund të kaloni nga MetroCard në OMNY në çdo kohë. Kur kaloni nga MetroCard në OMNY, ju mund të zgjidhni metodën që dëshironi për të paguar tarifën e reduktuar:

- Ju mund të përdorni një kartë OMNY, që jua dërgon FFNYC-ja;
- Ju mund të përdorni kartën tuaj OMNY; **ose**
- Ju mund të paguani me një kartë krediti personale, kartë debiti ose pajisje celulare.

Për pjesëmarrësit e regjistruar për zbritje për metrot dhe autobusët urbanë:

Zbritja juaj e Fair Fares NYC është vetëm për përdorimin tuaj. Nëse lejoni dikë tjetër që të përdorë kartën tuaj me zbritje, Programi mund t'ju pezullojë dhe t'ju heqë zbritjen. Shikoni seksionin e penaliteteve më poshtë për më shumë informacione.

Përdorimi i zbritjes së FFNYC-së me OMNY:

- Mund ta vendosni kartën ose pajisjen tuaj në çdo lexues kartash OMNY. Zbritja juaj do të vlejë për metrot, autobusët urbanë, Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram, dhe Hudson Rail Link. Zbritja juaj nuk do të vlejë për autobusët ekspres ose AirTrain JFK. Ju do të paguani tarifën e plotë për këto shërbime.
- Nëse bëni 12 udhëtime të paguara brenda 7 ditëve rresht, të gjitha udhëtimet shtesë në këtë hark kohor do të jenë automatikisht falas. **Kjo gjë do të jetë e vlefshme për sa kohë që ofrohet mbulimi i tarifës nga OMNY.**
- Mund të përdorni vetëm një metodë pagese me zbritjen tuaj: një Kartë OMNY, një kartë krediti ose debiti ose një pajisje celulare. Mundësia juaj për të ndryshuar metodën e pagesës mund të jetë e kufizuar sipas gjykimit të Programit.

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 3 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

Si funksionon karta OMNY:

Mund ta mbushni me para kartën OMNY në një makinë për kartat OMNY që ndodhet në stacionet e metrosë së NYCT-së ose në dyqanet pjesëmarrëse në të gjithë qytetin (omny.info/retail), duke telefonuar Shërbimin ndaj Klientit të OMNY-t në numrin (877)-789-6669 ose online përmes llogarisë së regjistruar të OMNY-t (omny.info/register).

- Programi nuk i mbulon apo rimbursen kostot e tarifës. Asnjë nga kartat që ju jep FFNYC-ja nuk do të ketë para në të.
- Përpara se të përdorni një kartë OMNY, do të duhet ta mbushni me para për të paguar tarifën për mënyrën e transportit që do të përdorni. Shuma më e vogël që mund të hidhet në kartën tuaj është \$1.00. Ju nevojitet një gjendje prej të paktën 50% të tarifës së deklaruar për të udhëtuar.

Si ta përdorni zbritjen tuaj me një kartë krediti ose debiti ose një pajisje celulare

Mund ta përdorni zbritjen tuaj me një kartë personale krediti ose debiti, ose një pajisje celulare. OMNY do t'ju faturojë tarifën e zbritur sa herë që vendosni kartën.

- FFNYC-ja do t'ju njoftojë kur zbritja të jetë aplikuar në kartën tuaj të kreditit ose debitit.
- Nëse dëshironi ta përdorni zbritjen tuaj me pajisjen tuaj celulare, prekni pajisjen në lexuesin OMNY pasi të jetë shtuar zbritja.
- Zbritja mund të përdoret vetëm me një version të kartës suaj të kreditit ose debitit: Për shembull, nuk do të mund ta përdorni zbritjen në kartën tuaj fizike nëse zbritja është në versionin dixhital të së njëjtës kartë në pajisjen tuaj celulare.
- Nëse karta juaj e kreditit ose debitit ka më shumë se një përdorues të autorizuar, vetëm një përdorues i autorizuar mund ta përdorë atë kartë me zbritjen.
- Nëse kaloni nga një kartë OMNY në një kartë krediti ose debiti ose pajisje celulare, karta juaj OMNY do të bëhet një kartë me tarifë të plotë.

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 4 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

Karta OMNY të humbura, të vjedhura, ose të dëmtuara:

- Identifikohuni në ACCESS HRA (AHRA) ose telefononi në numrin 311 për ta raportuar kartën tuaj si të humbur, të vjedhur ose të dëmtuar. Karta OMNY nuk do të funksionojë pasi të jetë anuluar.
- Ju mund ta zëvendësoni kartën tuaj OMNY me një kartë tjetër OMNY, ose me një kartë krediti ose debiti ose pajisje celulare.
- FFNYC-ja do të lëshojë vetëm një kartë OMNY zëvendësuese për çdo vit regjistrimi. Zëvendësimi për herë të dytë lejohet vetëm në rrethana të veçanta sipas gjykimit të Programit.
- Kur FFNYC-ja ju dërgon një kartë të re OMNY, çfarëdo shume në kartën e mëparshme do të kalojë në kartën e re.
- **OMNY NUK OFRON RIMBURSIME.**
- Nëse arrini limitin e kartës zëvendësuese, mund të shtoni zbritjen tuaj në kartën tuaj OMNY ose të përdorni një kartë krediti ose debiti ose pajisje celulare.
- Nëse e kaloni zbritjen tuaj në kartën tuaj OMNY, çfarëdo shume në kartën e mëparshme do të mbetet në llogarinë tuaj OMNY. Duhet të telefononi shërbimin ndaj klientit të OMNY në (877) 789-6669 për të transferuar paratë nga karta juaj e vjetër në kartën tuaj OMNY.
- Një Kartë Fair Fares OMNY (FFOC) e keqpërdoruar që ka para brenda nuk kualifikohet për rimbursim.

Kartë krediti, kartë debiti ose pajisje celulare e humbur, e vjedhur ose e dëmtuar

- Kontaktoni së pari bankën tuaj për të anuluar ose pezulluar kartën tuaj për të parandaluar transaksione të paautorizuara.
- Për të transferuar zbritjen tuaj në një kartë tjetër, hyni në AHRA. Për të kërkuar një kartë OMNY, hyni në AHRA ose telefononi në numrin 311.

Skadimi i një karte OMNY të lëshuar nga Fair Fares (FFOC):

- FFOC-ja juaj ka një datë skadimi në pjesën e pasme. Duhet të vazhdoni të përdorni të njëjtën kartë derisa ajo të skadojë. FFNYC-ja do t'ju dërgojë automatikisht me postë kartën e re para se ajo të skadojë nëse jeni ende të regjistruar në program.
- FFNYC-ja do të transferojë paratë tuaja nga karta e skaduar në kartën e re.

Nuk ka transfertë parash nga MetroCard në kartën OMNY:

- Nuk mund të transferoni asnjë gjendje të mbetur nga një MetroCard me tarifë të plotë ose nga një kartë OMNY me tarifë të plotë.
- Nuk mund të transferoni gjendjen e mbetur nga Fair Fares MetroCard në kartën tuaj Fair Fares OMNY. Duhet ta përdorni gjendjen e mbetur në MetroCard para se të skadojë ose të anulohet.

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 5 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

Kërkesa për rimbursimin e një FFM-je të humbur ose të vjedhur në përputhje me procedurat e NYCT-së:

Nëse FFM-ja juaj humb ose vidhet **dhe** ju keni blerë një leje 30-ditore udhëtimi me një kartë **kredit**, **debiti** ose **EBT-je**:

- Pasi të telefononi numrin 311 ose të identifikoheni në AHRA për të raportuar kartën tuaj të humbur ose të vjedhur, duhet të kontaktoni Autoritetin e Transportit të NYC-së duke telefonuar në numrin 511 ose (718) 330-1234 dhe duke ndjekur udhëzimet derisa të kontaktoni Programin e Mbrojtjes së Gjendjes (Balance Protection Program) për të kërkuar një rimbursim.
- Mund të kualifikoheni për rimbursim të pjesshëm në varësi të ditës kur keni njoftuar Programin e Mbrojtjes së Gjendjes që FFM-ja ka humbur ose është vjedhur **dhe**:
 - FFM-ja e humbur ose e vjedhur përmbante një leje 30-ditore udhëtimi;
 - Ka pasur ende kohë të mbetur për lejen 30-ditore të udhëtitimit në momentin e çaktivizimit; dhe
 - Ju keni paguar për një leje 30-ditore udhëtimi me kartë debit, kredit ose EBT.
- Nëse FFM-ja juaj humbet ose vidhet, ju mund të merrni një rimbursim falas të FFM-së për çdo vit kalendarik. Një rimbursim i dytë do të ketë një tarifë \$5.00 dhe nuk do të jepet asnjë rimbursim nëse shuma në kartë është më e vogël se \$5.00. Mund të merrni e shumta dy rimbursime çdo vit.

FFM-të që janë të dëmtuara ose që nuk funksionojnë:

Nëse nuk mund ta përdorni FFM-në tuaj për shkak se është e dëmtuar ose nuk funksionon, duhet ta riktheni FFM-në tuaj të dëmtuar ose jofunksionale në një zyrë të FFNYC-së.

Telefononi numrin 311 ose vizitoni www.nyc.gov/fairfares për të gjetur vendndodhjen më të afërt të zyrës. DSS-ja/HRA-ja do t'ju japë një FFOC zëvendësuese pasi t'ia riktheni Programit FFM-në tuaj të dëmtuar ose jofunksionale.

Skadimi i MetroCard

Nëse kanë mbetur para në FFM-në tuaj kur ajo skadon, mund të kërkonit një rimbursim.

Dërgojeni kërkesën tuaj me postë ose kthejeni kartën tuaj të skaduar në një zyrë të FFNYC-së. Çdo kërkesë për rimbursim duhet të bëhet brenda 2 vitesh nga data e skadimit në pjesën e pasme të kartës.

Për të dërguar një kërkesë me postë, përfshini informacionin e mëposhtëm në zarf me kartën tuaj:

- Emrin dhe mbiemrin tuaj.
- Numrin e ID-së së Fair Fares të klientit (që gjendet në faqen kryesore të Fair Fares në llogarinë tuaj të [ACCESS HRA](#)).
- Gjendjen totale që mendoni se ka mbetur në kartë.

Dërgoni Fair Fares MetroCard dhe informacionin e mësipërm në adresën:

Fair Fares NYC
PO Box 7099
New York, NY 10008-7099



Për pjesëmarrësit e regjistruar për zbritje për udhëtimet e Access-A-Ride (AAR):

- Pjesëmarrësit e Fair Fares të cilët janë përdorues të AAR-së dhe kërkojnë zbritje për udhëtimet e AAR-së nuk kualifikohen për të përfituar zbritje në metro dhe autobusë urbanë. Nëse e keni tashmë një zbritje në metro dhe autobusë urbanë, FFNYC-ja do të heqë zbritjen nga karta juaj ose pajisja celulare.
- Pasi i jepni programit numrin e ID-së suaj të Access-A-Ride dhe Autoriteti i Transportit i NYC-së konfirmon informacionin tuaj, zbritja do të zbatohet drejtpërdrejt në secilën llogari të AAR-së. Pasi të konfirmoheni nga AAR-ja, do të keni mundësinë të rezervoni udhëtime me zbritje në AAR gjatë periudhës së kualifikueshmërisë për Fair Fares. Zbritja do të zbatohet për udhëtimin kur ju e rezervoni atë dhe do ta paguani tarifën e zbritur vetëm kur udhëtimi të përfundojë.
- Ju jeni personi i vetëm që lejohet të përdorë zbritjen tuaj të tarifës së AAR-së. Nëse lejoni dikë tjetër të përdorë zbritjen tuaj, mund ta humbisni kualifikueshmërinë tuaj për Programin. Shikoni seksionin e penaliteteve më poshtë për më shumë informacione specifike.

Duke pranuar kushtet e përdorimit të FFNYC-së, ju njihni dhe pranoni kushtet dhe politikat që rregullojnë përdorimin e shërbimeve tona, duke përfshirë udhëzimet në lidhje me sjelljen e përdoruesit, privatësinë e të dhënave, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe kufizimet e përgjegjësisë.

Rinovimet në Programin FFNYC:

Programi do t'ju njoftojë të paktën 30 ditë përpara se të përfundojë periudha e regjistrimit në programin FFNYC. Më pas ju mund t'i dërgoni DSS-së/HRA-së një aplikim rinovimi. Pasi të miratohet aplikimi juaj për rinovim, zbritja juaj do të vazhdojë të funksionojë me të njëjtën metodë pagese që keni përdorur deri tani, përveç nëse ju kërkohet të përdorni një metodë të re pagese gjatë aplikimit tuaj për rinovim. Nëse FFOC-ja juaj skadon gjatë kohës që regjistroheni, një FFOC e re do t'ju dërgohet automatikisht para se të skadojë.

Mohim i përgjegjësisë:

Zbritjet e Fair Fares do të jenë të disponueshme për sa kohë Programi të jetë në fuqi. Nëse programi ndërpritet, zbritja do të hiqet nga karta juaj, por ju mund të vazhdoni të përdorni çfarëdo gjendje të mbetur në llogarinë tuaj të OMNY-t me tarifë të plotë. Zbritjet e Access-A-Ride do të përfundojnë menjëherë nëse programi ndërpritet.

Duke pranuar këto Kushte Përdorimi, ju gjithashtu pranoni që kjo marrëveshje lidhet midis jush si pjesëmarrës dhe DSS-së/HRA-së si administrator i programit FFNYC. NYCT nuk është palë në këtë marrëveshje.

Ndryshimet në këtë Marrëveshje:

DSS-ja/HRA-ja mund t'i ndryshojë kushtet e kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi kur të postohen në faqen e internetit të Fair Fares. Nëse një ndryshim e bën një pjesë të kësaj marrëveshjeje të pavlefshme, ndryshimi nuk e bën të gjithë marrëveshjen të pavlefshme. Kjo nënkupton që pjesa tjetër e kushteve të kësaj marrëveshjeje do të vijojë të jetë në fuqi.

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 7 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

Ligji në fuqi:

Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e shtetit të Nju-Jorkut dhe Kreu 12 i Pjesës 68 të Rregullave të qytetit të Nju-Jorkut. Për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të përdoren ligjet e shtetit të Nju-Jorkut.

Ndryshimet e informacionit tuaj:

Ju do t'i merrni njoftimet dhe FFOC-të zëvendësuese në adresën që kemi në dosjen tuaj. Ju pranoni të informoni DSS-në/HRA-në për çdo ndryshim të informacionit të dhënë nga ju, si:

- Emri;
- Adresa;
- Numri i telefonit; dhe
- Adresa e emailit.

Mund ta ndryshoni adresën postare ose informacionin e kontaktit duke vizituar www.nyc.gov/accessfairfares, duke telefonuar 311 ose duke vizituar zyrën e Fair Fares NYC.

Pakualifikueshmëria:

FFNYC-ja do ta heqë zbritjen nga karta juaj ose pajisja celulare nëse ose kur konstatohet se jeni të pakualifikueshëm për Programin. Mund të vazhdoni të përdorni kartën ose pajisjen celulare pa zbritjen nëse ajo nuk është çaktivizuar.

Kufizimet:

Ju jeni personi i vetëm që lejohet ta përdorë zbritjen tuaj të FF-së. Nëse lejoni dikë tjetër të përdorë zbritjen tuaj të FF-së, mund të largoheni nga Programi dhe nëse keni një FFOC, gjendja e mbetur në kartë mund të humbasë.

Si me të gjitha kartat OMNY, duhet t'ia tregoni FFOC-në tuaj çdo oficeri policie ose anëtar të stafit të transportit nëse ata e kërkojnë atë.

Programi mund t'ju heqë zbritjen nëse:

- Keni ndërhyrë te FFOC-ja; ose
- Keni lejuar dikë tjetër të përdorë FFOC-në ose pajisjen tuaj për të udhëtuar me metro ose autobus të kualifikueshëm me zbritjen tuaj.

Penalitetet:

Nëse e keqpërdorni zbritjen tuaj të FF-së ose e mashtroni Fair Fares NYC (duke përfshirë ndër të tjera dhënien e zbritjes dikujt tjetër për ta përdorur ose ofrimin e informacioneve të rreme qëllimisht për Fair Fares NYC), do të merrni një letër paralajmëruese dhe një pezullim prej 60 ditësh. Pasi të përfundojë pezullimi prej 60 ditësh, ju mund të riaplikoni për Programin. Nëse kryeni një shkelje të dytë, ju do të shkualifikoheni përgjithmonë nga Programi.

FFOC-të e keqpërdoruara që kanë para brenda nuk kualifikohen për rimbursim.

Emri dhe mbiemri

ID-ja e "Fair Fares"



FF-1c (AL) 06/10/2025 (page 8 of 8)
(E) 05/23/2025 LLF

E drejta për të kundërshtuar vendimin për kualifikueshmërinë:

Nëse jeni të pakualifikueshëm për Fair Fares NYC, ju keni të drejtë ta kundërshtoni vendimin e kualifikueshmërisë duke kërkuar një shqyrtim administrativ duke telefonuar në numrin 311 ose vizituar një zyrë të FFNYC-së.

Zbulimi:

DSS/HRA-ja mund të përdorë dhe të ndajë informacione personale të mbledhura rreth jush për pjesëmarrjen në Program për qëllime të caktuara, duke përfshirë ndër të tjera sa më poshtë:

- Administrimin e programit;
- Lidhjen tuaj me përfitimet, shërbimet dhe kujdesin shtesë për të cilat mund të kualifikoheni;
- Verifikimin e pjesëmarrjes në programin Access-A-Ride;
- Verifikimin e mospjesëmarrjes suaj në Programin e Tarifave të Redukuara (Reduced-Fare Program) të MTA-së dhe
- Mundësimin e agjencive ligjzbatuese që të hetojnë raste të dyshimta të mashtrimit në lidhje me Programin.

Zbritja e Fair Fares dhe përdorimi i saj janë subjekt i të gjitha dispozitave, rregullave dhe rregulloreve të Autoritetit të Transportit të NYC-së dhe partnerëve të tij.

Përdorimi i një FFOC-je do të jetë subjekt i të njëjta kushteve të përgjithshme dhe kufizimeve për pagesat dhe tarifat si përdorimi i FFM-së. Përdorimi i zbritjes së Fair Fares me OMNY është subjekt i Kushteve të Shërbimit të OMNY-t dhe Politikës së Privatësisë së OMNY-t që mund të gjendet te OMNY.info.

Lexojini dhe nënshkruajini këto Kushte Përdorimi dhe mbani një kopje për regjistrat tuaj.

Emri i pjesëmarrësit: (Me germa shtypi)

Data

Nënshkrimi i pjesëmarrësit

Për shërbimin ndaj klientit ose më shumë informacion, telefononi në numrin 311. Nëse jeni dikush që nuk dëgjon ose ka vështirësi me dëgjimin, telefononi në numrin 711 ose ofruesin e preferuar të shërbimit të ndërmjetësimit për të na kontaktuar.